

Living

Dimër 2023 NR 61



VITI I MBARË I
LORIK CANËS
"Po bëj jetën që dua"

VITI IMBARË I LORIK CANËS

“PO
BËJ
JETËN
QË
”DUA

Këto ditë të fundit të Dhjetorit, por edhe gjatë Janarit, po të flasësh në telefon me Lorik Canën, do dëgjosh gjithnjë ca zëra fëmijësh që nuk ndalen asnjëherë. Sidomos të së bijës, Enkeleidës, që është vetëm katër veç. Ndryshe nga ritmi i muajve të tjerë të vitit, që e gjen Lorikun në avion o në makinë, duke udhëtuar, këto janë ditët e qeta që ia kushton tërësisht familjes. Orët e fundit të vitit po i kalon në Romë, atje ku prej kohësh ka gjetur rehatinë për të jetuar. Qetësia e natyrës, në periferi të qytetit të Italisë, është ajo çfarë i duhet atij dhe fëmijëve në këto ditë festash. Pastaj, nëse shtojmë edhe faktin që familja e Monikës, duke pasur një restorant, i gostit me të gjitha dëshirat, pushimi bëhet ideal. Në këtë inervistë, ish futbollisti dhe kapiteni Kombëtares, Lorik Cana, imazhi i Tringut dhe Champions League, na tregon për festat e shtëpisë së tij, fëmijët, pasionet dhe, sigurisht, për vitin historik të Kombëtares që do ta mbështesë në Gjermani.

3D artist
Rigers Zeneli
Redis Sinani
Kristi Hila
Gent Bamkallari

Intervista nga: Ani Jaupaj
Fotografia: Dionis Ferizi
Kostumograf: Ardi Asllani
Dizajni Grafik: Aldo Beshiri





Je dalluar përherë, jo vetëm prej aftësive profesionale, por edhe për vëmendjen ndaj pasioneve, shijes, look-ut, historisë. Si kanë ndryshuar këto pasione në raport me kohën, sidomos tani që ke mundësi për t'iu përkushtuar më shumë se më parë?

Nuk e di nëse dalloj nga të tjerët. Jam munduar gjithmonë që gjatë karrierës time të jem i përkushtuar, të bëj më të mirën në fushë por mbi të gjitha me qendrimin dhe vrytytet që përpiqem të kem në fushë dhe jashtë fushe. Marrëdhënia me njerëzit e sportit nuk është e ndryshme nga ata jashtë saj. Është e vërtetë që marrëdhënien kryesore, edhe për shkak të kohës, e ke me bashkëlojtarët e me stafin teknik, por gjatë ditës ne të gjithë takojmë shumë njerëz që kanë role të ndryshme. Pastaj janë tifozët, shumë të rëndësishëm, aponjerëzit e jetës së përditshme me të cilët ndajmë pasionet e përbashkëta. Njeriu nuk duhet të ndryshojë mënyrën si është në rrethin ngushtë krahasuar me ata që takon jashtë saj. Sigurisht besimi që mund të përcjellësh te një njeri që

nuk e njeh, krahasuar me një tjetër, nuk është i njëjti por respekti duhet të jetë po ai. Sa i përket kohës, jam munduar të kem pasionet e mia dhe tani që nuk jam më pjesë aktive e futbollit po i pasuroj edhe më tepër. Trashëgimia kulturore, historia e Shqipërisë, promovimit të sportit përmes Fondacionit 'Lorik Cana' janë në fokusin tim. Tashmë koha më ndihmon të jem shumë më i kushtuar. Sa i përket televizionit, të qenit imazh i Tringut dhe Champions League është një proces që e kam shijuar shumë dhe kur punon në televizion duhet të tregosh gjithnjë kujdes ndaj vetes, prandaj më ka bërë mirë të qenit imazh publik, edhe duke mos qenë në futboll, sidomos me një kompani serioze si Tringu dhe një garë si Champions. Sigurisht, jetën po e shijoj më shumë tani se sa në kohën kur isha futbollist sepse angazhimi dhe regjimi ishin absolut dhe të privonin nga disa gjëra.

Historia dhe arkeologjia kanë qenë gjithashtu pasionet e tua. Si i ke zhvilluar a pasuruar me kohën? Di që në bibliotekën tënde,

gjë jo dhe aq e zakonshme për futbollistët, ka enciklopedi dhe libra të rëndësishëm të historisë së Shqipërisë.

Vërtet që historia dhe arkeologjia janë gjëra që më kanë interesuar gjithnjë. Është e rëndësishme për mua të di prejardhjen dhe ta promovoj atë. Kjo është edhe arsyeja pse Fondacioni është i ndarë në dy fusha, njëra për promovimin e sportit te fëmijët, ku kemi qindra fëmijë prej vitesh, dhe pjesa tjetër e Fondacionit është promovimi i kulturës dhe historisë shqiptare. Kur diçka e do dhe e bën me pasion ti nuk lodhesh dhe as të shteron dëshira për të shtuar projektet dhe aktivitetet. 2023-shi ka qenë tejet i mbushur me aktivitete. Për herë të parë kemi bërë edhe një cikël dokumentarësh për historinë e arbëreshëve që do të shfaqet gjatë 2024-ës. Koha e lirë ka bërë që të ndjek ëndrrat dhe pasionet e mia. Vazhdoj të marr informacion dhe të lexoj vazhdimisht për gjërat që më pëlqejnë, prandaj mund të them se po bëj jetën që dua.

Sa angazhoheni, bashkë me Monikën, për të krijuar në shtëpi një atmosferë festash?

Në fakt këtë ia dedikoj Monikës. Nuk është se unë nuk u jap rëndësi, por ajo është më tepër e dedikuar për të krijuar një atmosferë të mirë, festive e të dashur për fëmijët, kështu që mund të them se kam fat që e kam sepse vetë, nga kjo pikëpamje, kam shumë mangësi.

Çfarë shijojnë më shumë, për t'u argëtuar, fëmijët tuaj në ditët e festave si këto?

Djali, Bojkeni, që është 8 vjeç, si gjithë moshatarët e tij besoj, sheh lojëra që janë argëtuese, por ka edhe lojëra që ka dëshirë t'i bëjë me mua. I pëlqen të marrë dhurata që lidhen me sportin, të luajmë ping pong bashkë, të përfshihet në aktivitete sportive. Për shembull, do ta gëzonte një raketë e re tenisi, futbollin e do gjithashtu shumë. Ndërsa vajza e vogël është në moshën kur luan me gjithçka. I pëlqen të ndjek pak villain, por rëndësi ka që të ketë dikë pranë saj që ta përfshijë në lojëra. Prandaj meqenëse unë nuk e kam pasur afër familjen time, në kohë fes-

tash përpiqem që t'ua dedikoj të gjithë kohën fëmijëve duke qenë se e kam ndier mungesën vetë.

Si janë ritualet tuaja të festive? Shijet kulinare? A është edhe gatimi pjesë e pasioneve të tua apo i gruas tuaj?

Sa i përket kulinarisë, meqenëse i kalojmë festat në Itali, nuk jemi asnjëherë keq për ushqim të mirë, por, nga ana tjetër, kemi fatin që familja e Monikës ka një restorant të famshëm në Romë, prandaj këto festa i kalojmë përherë në periferi të Romës, ku është restoranti. Në këtë mënyrë fëmijët kanë mundësi të qëndrojmë në natyrë, të dalin nga qyteti ku rrijnë gjatë gjithë vitit. Jemi me fat që kemi prindërit e saj që kujdesen për ne në këtë pikëpamje, pavarësisht që ushqimi i jashtëzakonshëm i Italisë ta ofron këtë mundësi ngado. Edhe Monika përpiqet që të gatuj, bën thujse gjithçka, përveç mishit të dërrit që nuk e gatujmë shumë në familjen time. Recetat e festës janë ato tradicionalet, që nga gjeli i detit deri te të gjitha pjatat festive. Por nuk mund të them se abuzojmë në këtë pikëpamje, thjesht shfrytëzojmë kohën

për të qëndruar bashkë.

Cili ka qenë për ty dhjetori më i bukur, ai që veçon nga të tjerët?

Dhjetorin më të bukur është vështirë ta kujtoj, por sigurisht ka qenë sa herë që kam pasur mundësi të mbledh bashkë gjithë familjen. Meqenëse ne, si emigrant, i kemi familjarët larg, disa në Kosovë, disa në Francë e ne këtu në Itali, i shijojmë plotësisht vetëm atëherë kur bëhemi bashkë. Sigurisht që udhëtoj shpesh dhe i takoj sa herë mundem. Jam me fat që kam mundësinë t'i ndjek aktivitetet e mia edhe në distancë, por mundohem që kur familja ka nevojë të lëviz gjatë verës apo në pushime dimri të marrim kohën tone, ndërsa gjatë vitit nuk lëvizim shumë sepse kemi fatin që afër Romës të kemi vende të mrekullueshme për të qëndruar, kështu që gjatë fundjave nuk largohemi shpesh.



Si e sheh ekipin e Kombëtares sot? Ka pasur arritje të rëndësishme...

Sigurisht që e shoh me një sy të mirë, është një vit historik për Kombëtaren, për sportin dhe futbollin, nga një skuadër që ka bërë një fazë kualifikuese të jashtëzakonshme. E gjithë kjo, pavarësisht në je pjesë

e ekipit apo jo, të jep ndjesi të shkëlqyera, por mbi të gjitha po përfaqësohet nga çdo cep ku jetojnë

shqiptar, po vijmë me dashurinë dhe përgjegjësinë e duhur për çfarë përfaqëson ekipi kombëtar. Unë i jap shumë rëndësi kësaj, pastaj nga aspekti sportiv kemi qenë të aftë të bëjmë përfaqësime të mira, kemi pasur lojtar që kanë bërë ndryshime, një trajner që ka pasur impakt të jashtëzakonshëm dhe në

fund ka qenë një punë e shpërblyer në mënyrën më të mirë. Është krenari, për çdo shqiptar, që të lartësohet emri i Shqipërisë. Por është edhe një punë e vazhdueshme për ta çuar më tej suksesin.

Mirëpo tani mendoj që duhet të shijojmë faktin që jemi në Euro 2024, në Gjermani, dhe të mbështesim Kombëtaren tonë.

A ka momente që ndjen se u tërhoqe përpara kohe nga futbolli?

Unë e kam ditur së paku një vit përpara se të tërhiqesha. Sigurisht, më ka munguar jashtëzakonisht shumë. Pjesa e kompeticionit

dhe adrenalinit të mungon, por do isha penduar nëse do mund ta vazhdoja dhe se bëra, por meqenëse kam pasur probleme shëndetësore për ta vijuar, nuk e kisha në dorë. Kjo ka qenë arsyeja pse nuk kam ngelur peng i një vendimit tim.

A luan futboll me Bojkenin? E do ai sportin njësoj si ju? Po vajzës, çfarë i pëlqen më shumë?

Me djalin luajmë shumë, tre herë në javë ai shkon në stërvitje dhe një herë në javë ka ndeshje. Luan edhe tenis sepse për mua është e rëndësishme që në këtë moshë të ushtrojnë sportin sepse përmes tij ke mundësi të mësosh dhe të zhvillosh veten. E ka dëshirën për t'u marrë e për t'u rritur me vlerat e sportit. Fëmijët sportiv, sidomos në kohët që po jetojmë, e kanë një shtysë në jetë për të përballuar sfidat . Vajza është ende e vogël, bën 4 vjeç në Janar. Vajzat janë bekime për ballarët dhe mua vërtet më ka vendosur në një botë tjetër, e dua kaq shumë të voglën time që është si një uragan, gjithë kohën.

Lorik, në Shqipëri, nuk mjaftojnë asnjëherë gjërat që shkruhen për ty. Edhe kur nuk thuhet gjëra të reja, të gjithë lexojnë, kështu që na trego për planet që ke për vitin e ardhshëm. Ku do të të gjejë Janari??

Gjatë Janarit jam më i qetë sepse sezoni televiziv nis në Shkurt. Është një muaj kur i dedikohem familjes, fillon riprojektimi i Fondacionit 'Lorik Cana' për 2024, bëhen strategjitë për të rritur përfaqësimin e Shqipërisë përmes kulturës tonë këtu në Itali dhe vende të tjera. Unë i kam fëmijët ende të vegjël dhe e konsideroj shumë të rëndësishme kohën që duhet të kaloj me ta. Nga ana tjetër, duhet të ndihmoj edhe gruan sepse familja ka edhe babanë edhe nënën, duhet të impenjohen të dy. Mendoj që në Shkurt do të bëjmë pak pushime për të thyer dimrin, pastaj i rikthehem sezonit . Kam gjetur një ekuilibër këtu në Romë, kështu që do ta vijojë jetën time këtu, të paktën edhe për sa kohë fëmijët të rriten edhe pak dhe të bëjnë zgjedhjet e tyre, por deri tani them se është një vend shumë i mirë për të jetuar.

ËSHTË NJË VIT HISTORIK PËR KOMBËTAREN, PËR SPORTIN DHE FUTBOLLIN, NGA NJË SKUADËR QË KA BËRË NJË FAZË KUALIFIKUESE TË JASHTËZAKONSHME.

